

RAPORT MONITORIMI I POLITIKËS

Raportimi dhe Trajtimi i Ngacmimeve në Shkolla

Komuna e Lipjanit

Autor: Rinor Murati

Rishikues: KYC Kosova

Dizajni: Sh.P.K. "SUKI"

"Social Urban Innovation Kosova"

Të drejtat e autorit © 2025. Këshilli Rinor Kosovar (KYC).

Të gjitha të drejtat e rezervuara. Ky dokument është pronë e KYC, andaj çdo kopjim, përdorim i plotë apo i pjesshëm i materialit pa cituar burimin apo pa lejen paraprake të KYC ndalohet.

Raportimi dhe Trajtimi i Ngacmimeve në Shkolla

Rasti Shembull - Komuna e Lipjanit



Ky raport u realizua me mbështetjen financiare të Unicef Kosovo Programme, IOM Kosovo dhe Peacebuilding Fund, si produkt i iniciativës së implementuar nga KYC Kosova dhe Këshilli i Nxënësve të Lipjanit.

Pikëpamjet e shprehura në këtë dokument nuk shprehin medoemos qëndrimet e autorëve/rishikuesve, KYC-it apo të donatorëve.

Hyrje

Ngacmimet janë një fenomen shqetësues në shkollat e mesme, të cilat ndikojnë negativisht në ndjenjën e sigurisë dhe mirëqenien e nxënësve. Gjatë takimeve me Këshillat e Nxënësve, është evidentuar se rastet e ngacmimeve (ndër më të shpeshtat: ngacmimet seksuale, bullizmi) nuk trajtohen në mënyrë efektive, duke çuar në mungesë besimi në institucionet arsimore, heshtje të rasteve si dhe hezitim nga nxënësit për t'i raportuar ato.

Ky monitorim ka dy qëllime kryesore:

- Të analizojë nëse politikat ekzistuese për ngacmimet (bullizmi, ofendimet, ngacmimet seksuale) janë të qarta dhe zbatohen në shkollat e mesme;
- Të japë rekomandime konkrete për përmirësimin e sistemit të raportimit dhe trajtimit të rasteve.

Metodologjia

Të dhënat mbi raportimin dhe trajtimin e ngacmimeve në shkolla për komunën e Lipjanit, do të fokusohen në dy aspekte:

I. Analizimi i ligjeve dhe dokumenteve ekzistuese;

II. Analizë e situatës aktuale në terren;

Kjo analizë përfshin:

- Të dhëna nga takimi me Këshillin e Nxënësve të Komunës së Lipjanit;
- Të dhëna nga diskutimi me akterët arsimorë (drejtorë shkollash dhe zyrtarë të DKA-së);
- Të dhëna nga një pyetësor i përgjithshëm mbi perceptimet e nxënësve në lidhje me llojet e ngacmimeve, raportimin dhe trajtimin e tyre.

Analizimi i ligjeve, rregulloreve dhe dokumenteve ekzistuese

I.1 Rregullore Qrk- Nr. 21/2013 për Protokollin për Parandalimin dhe Referimin e Dhunës në Institucionet e Arsimit Parauniversitar

Ky protokoll rregullon parandalimin, identifikimin, raportimin dhe trajtimin e të gjitha formave të dhunës dhe ngacmimit në institucionet parauniversitare, duke synuar mbrojtjen e nxënësve dhe krijimin e një mjedisi të sigurt. Ai kërkon bashkëpunim ndërinstitucional (shkolla, DKA, polici, etj.).

*Rregullore
QRK- Nr.
21/2013 për
Protokollin
për
Parandalimi
n dhe
Referimin e
Dhunës në
Institucionet
e Arsimit
Parauniversi
tar*

Detyrimet kryesore të shkollave përfshijnë:

- Krijimin e një Ekupi për Parandalimin dhe Referimin e Dhunës.
- Raportimin e menjëhershëm të rasteve të dhunës tek autoritetet.
- Mbajtjen e evidencës së dokumentuar të rasteve.
- Ofrimin e mbështetjes psikologjike për viktimat.
- Ndërmarrjen e masave disiplinore ndaj autorëve.
- Informimin e nxënësve dhe prindërve për raportimin dhe mbrojtjen.
- Organizimin e trajnimeve për stafin.
- Bashkëpunimin me institucionet e tjera për raste komplekse.

I.2 Ligji Nr. 05/L-021 për Mbrojtjen nga Diskriminimi

Ky ligj e përcakton ngacmimin si një formë diskriminimi dhe obligon institucionet të ndërmarrin masa parandaluese dhe të trajtojnë rastet në mënyrë efektive. Ligji detyron shkollat dhe Drejtoritë Komunale të Arsimit që të:

- Krijojnë mekanizma të qartë për mbrojtjen nga diskriminimi dhe trajtimin e rasteve të ngacmimit;
- Caktojnë persona përgjegjës brenda shkollave për monitorimin dhe raportimin e rasteve të diskriminimit dhe ngacmimit;
- Sigurojnë që çdo ankesë të trajtohet në mënyrë të paanshme dhe efektive;
- Parashikojnë masa ndëshkimore për ata që kryejnë ose nxisin diskriminim apo ngacmim në ambientet shkollore.

*Ligji Nr.
05/L-021 për
Mbrojtjen
nga
Diskriminimi
(2015).*

I.3 Ligji Nr. 05/L-020 për Barazi Gjinore

Ky ligj ndalon qartë ngacmimin dhe ngacmimin seksual, duke e konsideruar atë si cenim të dinjitetit të individit. Ai kërkon gjithashtu që institucionet arsimore të promovojnë barazinë gjinore përmes edukimit dhe mekanizmave të monitorimit.

Detyrimet për shkollat dhe drejtoritë komunale:

- Sigurimi i një ambienti të sigurt dhe pa diskriminim për të gjithë nxënësit.
- Përfshirja e edukimit për barazinë gjinore dhe parandalimin e dhunës në kurrikulën shkollore.
- Caktimi i zyrtarëve për barazi gjinore në nivel komunal dhe shkollor për të monitoruar dhe raportuar raste të ngacmimit dhe diskriminimit.
- Ofrimi i trajnimeve për stafin arsimor për të identifikuar dhe adresuar rastet e ngacmimit dhe pabarazisë gjinore.
- Hartimi dhe zbatimi i strategjive për eliminimin e stereotipeve gjinore në mjedisin shkollor.

Ligji Nr.
05/L-020 për
Barazi
Gjinore
(2015).

I.4 Ligji Nr. 06/L-084 për Mbrojtjen e Fëmijës

Ky ligj përcakton detyrimet e institucioneve arsimore për të siguruar një mjedis të sigurt dhe mbrojtës për fëmijët, duke kërkuar politika për parandalimin dhe adresimin e çdo forme të dhunës, abuzimi, shfrytëzimi dhe neglizhimi. Ai obligon personelin arsimor të jetë i trajnuar për identifikimin dhe raportimin e rasteve të tilla, duke bashkëpunuar me mekanizmat lokalë të mbrojtjes së fëmijëve.

Shkollat dhe DKA-të kanë përgjegjësi për:

- Identifikimin dhe parandalimin e ngacmimeve dhe dhunës ndaj fëmijëve.
- Sigurimin e një mjedisi të sigurt për nxënësit.
- Trajnimin e stafit për njohjen dhe reagimin ndaj ngacmimeve.
- Raportimin e rasteve te autoritetet përkatëse.
- Bashkëpunimin me organizatat dhe institucionet lokale për mbrojtjen e fëmijëve.
- Bashkëpunimin me organizata dhe institucionet lokale për mbrojtjen e fëmijëve dhe krijimin e një sistemi mbrojtës.

Ligji Nr.
06/L-084 për
Mbrojtjen e
Fëmijës
(2019).

I.5 Module Tematike për Mbrojtjen e Fëmijës (MASHTI)

Këto module synojnë të ofrojnë udhëzime për parandalimin e dhunës dhe bullizmit në shkolla. Ato përfshijnë tematika të rëndësishme si:

1. Mbrojtja nga ngacmimet seksuale dhe bullizmi;
2. Parandalimi i dhunës në mjediset shkollore dhe familjare;
3. Promovimi i barazisë gjinore dhe respektit për të drejtat e fëmijëve;
4. Vetëdijësimi i nxënësve dhe stafit arsimor mbi mekanizmat e raportimit të rasteve të ngacmimit.

Detyrimet për shkollat dhe Drejtoritë Komunale sipas këtyre moduleve:

- Implementimi i moduleve në kurrikulën shkollore dhe aktivitete jashtëkurrikulare.
- Krijimi i hapësirave të sigurta për nxënësit ku mund të raportojnë raste të ngacmimit dhe dhunës.
- Angazhimi i psikologëve shkollore për të ofruar mbështetje dhe këshillim për viktimat e ngacmimit.
- Sigurimi i bashkëpunimit me institucionet përkatëse për të adresuar rastet e raportuara.

Analizë e situatës në terren

Fenomeni i dhunës dhe ngacmimeve në shkolla nuk është një fenomen i panjohur në ambientet e shkollës. Marrë për bazë Komunën e Lipjanit, si mostër janë marrë dy shkolla fillore dhe të mesme të ulëta të Komunës së Lipjanit: SHFMU “Hasan Prishtina” Lllugaxhi dhe SHFMU “Kadri Beba” Ribar i Madh dhe një shkollë e mesme e lartë, Shkolla e Mesme Profesionale “Adem Gllavica”. Për analizë të mëtutjeshme, u realizuan edhe takime me zyrtarë nga Drejtoria Komunale e Arsimit, për të kuptuar nëse ka rregullore, mekanizma apo zyrtarë të emëruar që i trajtojnë më nga afër rastet e raportuara.

Diskutim me drejtorët e shkollave

Fenomenet më të theksuara

Bazuar në diskutimet me drejtorët e shkollave, rastet e dhunës dhe ngacmimeve – duke përfshirë abuzimin, bullizmin dhe forma të tjera – raportohen më rrallë në shkollat fillore dhe të mesme të ulëta, ndërsa janë më të pranishme në shkollat e mesme të larta. Sipas tyre, kjo prirje mund të shpjegohet me karakteristikat zhvillimore të kësaj grupmoshe, përfshirë fazën e pubertetit, e cila shpesh shoqërohet me ndryshime emocionale dhe të sjelljes që mund të çojnë në rritje të tensioneve dhe konflikteve mes bashkëmoshatarëve.

Sipas drejtorëve të shkollave, dhuna fizike ndërmjet nxënësve përbën një shqetësim të vazhdueshëm, siç dëshmohet nga të dhënat e mbledhura në terren. Ndër faktorët kryesorë që lidhen me përshkallëzimin e këtyre rasteve, përmendet përdorimi i rrjeteve sociale. Komunikimet konfliktuale në këto platforma shpesh vazhdojnë jashtë hapësirës digjitale dhe marrin formë fizike në ambientet shkollore apo përreth tyre, duke rritur kompleksitetin e menaxhimit të situatave të dhunës në shkolla.

Mekanizmat për raportimin e rasteve

Në të tri shkollat janë funksional mekanizmat: Këshilli Drejtues i Shkollës, Këshilli i Prindërve dhe Këshilli i Nxënësve, nëpërmjet të cilëve edhe raportohen, shqyrtohen dhe parandalohen rastet e ngacmimeve, dhunës apo forma tjera të sjelljeve të papërshtatshme në ambientet shkollore.

Në të tri këto shkolla, janë prezente kutitë e ankesave, të cilat shërbejnë si mekanizëm për raportimin e pakënaqësive, të cilat më pas shqyrtohen nga organi kompetent i shkollës.

Në bazë të informacioneve të grumbulluara, nëse paraqitet një rast ku pretendohet për ndonjë formë ngacmimi, ai rast fillimisht paraqitet tek kryetari/ja i/e klasës, nga ai/ajo tek kujdestari/ja i/e klasës dhe nga ai/ajo tek organi udhëheqës i shkollës. Nëse rasti vlerësohet se është i përmasave më të mëdha e që kërkon trajtim më të gjerë, atëherë njoftohen organet kompetente si: Drejtoria Komunale e Arsimit, Stacioni Policor dhe Qendra për Punë Sociale.

Diskutim me DKA në komunën e Lipjanit

Sipas të dhënave të mbledhura nga zyrtarët e Drejtorisë Komunale të Arsimit, nuk ekziston një rregullore specifike që parashikon trajtimin dhe parandalimin e rasteve të dhunës, ashtu si dhe mekanizmat përkatës për shqyrtimin e tyre. Megjithatë, ka organe të tjera, si Komisioni për Parandalimin e Dhunës në Familje dhe Dhunës me Bazë Gjimore, që mbikëqyrin çështje të tilla. Sipas informacionit të ofruar nga këto struktura, rastet e dhunës trajtohen në shkolla, përveç atyre që kërkojnë ndërhyrje dhe raportim në nivele më të larta të autoriteteve.

Diskutim me nxënësit e shkollave

Në kuadër të kësaj analize, janë mbledhur të dhëna edhe nga diskutimet me nxënës dhe përfaqësues të të tri shkollave të mesme të larta në komunën e Lipjanit. Diskutimet vunë në pah raste të ngacmimit dhe bullizmit, që nuk i përkasin vetëm raportit nxënës – nxënës, por edhe mësimdhënës – nxënës. Sipas tyre, një numër i konsiderueshëm i këtyre rasteve nuk raportohen. Arsyet për mosraportimin e tyre, ose për hezitimin për të vepruar në këtë drejtim, përfshijnë: frikën nga paragjykimi që vjen nga rrethi shoqëror, mungesën e besimit se këto raste trajtohen në mënyrë serioze dhe shqetësimin për mungesën e konfidencialitetit, si nga stafi shkollor, ashtu edhe nga Këshillat e Nxënësve. Kur u pyetën për mekanizmat alternativë të raportimit, siç janë kutitë e ankesave, përfaqësues të të dy shkollave theksuan se ato përdoren rrallë nga nxënësit. Disa nga perceptimet e nxënësve mbi efektivitetin e kutive të ankesave si formë e raportimit, përfshijnë:

- Vendosjen e kutive në hapësira të ekspozuara, gjë që e cenon anonimitetin e nxënësve;
- Trajtimi i pamjaftueshëm i ankesave të vendosura në to;
- Pavarësisht se kutitë hapen, nxënësit rrallë marrin informatë kthye në lidhje me to;
- Në disa raste, ato hapen vetëm nga drejtoria e shkollës, ani pse hapja e kutive duhet të bëhet nga Këshilli Drejtues i Shkollës për të siguruar transparencë.

Të gjeturat nga pyetësi

Për të kuptuar më tepër perspektivën e nxënësve rreth ngacmimeve dhe raportimit, Këshilli i Nxënësve të Lipjanit realizoi një pyetësor.

Pyetësi u shpërnda tek 149 nxënës nga tri shkolla të mesme të larta të Komunës së Lipjanit i cili përmban 17 pyetje mbi përvojat e tyre me ngacmimin dhe mekanizmat e raportimit. Përkundër mostrës së vogël të pjesëmarrësve, të dhënat e grumbulluara shërbejnë si një pasqyrë e përgjithshme dhe një pikënisje për të eksploruar më tej të gjeturat.

Të gjeturat nga pyetësi ofrojnë një perspektivë mbi këto aspekte:

Përhapja e bullizmit dhe e ngacmimeve

- Një numër i konsiderueshëm nxënësish (35 nga 149, afërsisht 23.5%) kanë qenë viktimë të bullizmit ose ngacmimeve gjatë shkollimit të tyre.
- Një pjesë më e vogël (16 nga 149, afërsisht 10.7%) pranojnë se kanë qenë shkaktarë të bullizmit ose ngacmimeve. Kjo tregon se mund të ketë një nën-raportim të rolit si shkaktar, gjë që nënkupton se numri i nxënësve që kanë pranuar se kanë qenë shkaktarë të bullizmit ose ngacmimeve mund të jetë më i ulët se numri real i nxënësve që kanë kryer veprime të tilla.
- Pothuajse gjysma e nxënësve (74 nga 149, afërsisht 49.7%) kanë qenë dëshmitarë të rasteve të dhunës, bullizmit apo ngacmimit, duke sugjeruar se këto dukuri janë të dukshme në mjedisin shkollor.
- Kur u pyetën për dukuritë më prezente, bullizmi dhe ngacmimet u renditën si më të shpeshtat, duke konfirmuar shqetësimin e nxënësve për këtë çështje.

Ndërgjegjësimi dhe raportimi

- Shumica e nxënësve (97 nga 149, afërsisht 65.1%) janë të vetëdijshëm për mënyrat e raportimit të bullizmit, gjë që është pozitive.
- Një numër edhe më i madh (111 nga 149, afërsisht 74.5%) ndihen të sigurt t'i raportojnë rastet e dhunës, ngacmimeve apo bullizmit. Kjo është një shenjë e mirë e besimit potencial në mekanizmat e shkollës.
- Megjithatë, pavarësisht kësaj, një numër shumë i madh nxënësish (129 nga 149, afërsisht 86.6%) deklarojnë se asnjëherë nuk kanë raportuar raste të tilla. Kjo mund të tregojë se ndjenja e sigurisë për të raportuar nuk përkthehet gjithmonë në veprim, ndoshta për shkak të frikës nga paragjykimimi ose mungesës së besimit në trajtimin serioz të rasteve.

Roli i psikologut/es së shkollës:

- Shumica e nxënësve (121 nga 149, afërsisht 81.2%) deklarojnë se e njohin rolin e psikologut/es në shkollë.
- Një numër i mirë (98 nga 149, afërsisht 65.8%) deklarojnë se ndihen të sigurt ta vizitojnë psikologun/en për problemet e tyre ose rastet e bullizmit.
- Megjithatë, shumica dërrmuese (105 nga 149, afërsisht 70.5%) deklarojnë se nuk e kanë vizituar kurrë psikologun/en e shkollës. Kjo mund të tregojë një hezitim për të kërkuar ndihmë ose mungesë të nevojës së perceptuar.

Perceptimet dhe besimet:

- Një numër i konsiderueshëm nxënësish (104 nga 149, afërsisht 69.8%) besojnë se viktimat e dhunës, ngacmimeve apo bullizmit paragjykojnë nga shoqëria nëse raportojnë. Kjo paraqet një pengesë të madhe për raportimin.
- Më shumë se gjysma e nxënësve (81 nga 149, afërsisht 54.4%) nuk besojnë se raportimet trajtohen me seriozitetin e duhur deri në zgjidhje. Kjo mund të minojë besimin në sistemin e raportimit.
- Shumica dërrmuese e nxënësve (122 nga 149, afërsisht 81.9%) nuk mendojnë se stafi arsimor janë shkaktarë të dhunës, ngacmimeve apo bullizmit, duke treguar një besim relativisht të lartë tek mësuesit në këtë aspekt.
- Një numër i madh nxënësish (121 nga 149, afërsisht 81.2%) besojnë se rrjetet sociale janë ndër shkaktarët kryesorë të dukurive negative në shkollë, duke theksuar ndikimin e botës online në mjedisin shkollor.

Intervenimet dhe ndërgjegjësimi:

- Më shumë se gjysma e nxënësve (91 nga 149, afërsisht 61.1%) raportojnë se kanë pasur diskutime, punëtori, trajnime ose sesione vetëdijësuese rreth bullizmit dhe dukurive të tjera në shkollë ose nivel komunal. Megjithatë, një numër jo i vogël (58 nga 149, afërsisht 38.9%) nuk kanë pasur të tilla, duke sugjeruar se mund të ketë nevojë për më shumë iniciativa të tilla.

Të dhënat tregojnë se bullizmi dhe ngacmimet janë dukuri të pranishme dhe të perceptuara si të shpeshta nga nxënësit. Ndërsa ka një vetëdijësim të konsiderueshëm për mënyrat e raportimit dhe një ndjenjë të përgjithshme sigurie për ta bërë këtë, numri i raportimeve aktuale është shumë i ulët. Kjo mund të jetë e lidhur me frikën nga paragjykimi dhe mungesa e besimit në trajtimin efektiv të rasteve. Roli i psikologut të shkollës njihet, por vizitat mbeten të pakta. Rrjetet sociale shihen si një faktor i rëndësishëm kontribues në dukuritë negative. Ka pasur përpjekje për ndërgjegjësim, por jo të gjithë nxënësit kanë qenë të përfshirë.

Mangësitë e identifikuara në përputhje me kornizën ligjore dhe rregullative

Mungesa e një rregulloreje specifike në nivel komunal për trajtimin e dhunës dhe ngacmimeve në shkolla

Drejtoria Komunale e Arsimit në Lipjan deklaron se nuk ka një rregullore të veçantë që trajton dhunën në shkolla, gjë që krijon boshllëk institucional në reagim të strukturuar ndaj këtij fenomeni.

Ekipet për parandalimin e dhunës, raportimit dhe ofrimit të mbështetjes psikologjike ekzistojnë formalisht

Nxënësit shprehin mungesë besimi dhe frikë nga stigmatizimi, andaj ka hezitim nga ana e tyre që t'i raportojnë rastet. Tutje, në bazë të diskutimit me nxënës, ata nuk janë të informuar në masë të duhur për format e raportimit në rast të dhunës apo ngacmimeve në shkollë.

Kutitë e ankesave nuk plotësojnë standardet e konfidencialitetit

Vendosja e kutive në hapësira të ekspozuara, mungesa e transparencës dhe e informatës kthyesë tek nxënësit, e bëjnë këtë mjet raportimi jo funksional.

Shkollat e përfshira në monitorim nuk kanë zyrtarë të caktuar për barazi gjinore

Edukimi për këtë çështje shpesh mungon në aktivitetet ditore ose planifikimet mësimore. Nxënësit shprehen se ka pjesëtarë të stafit shkollor të cilët shpesh me apo pa dashje i thellojnë stereotipet gjinore përmes komenteve dhe qëndrimeve të tyre.

Shkollat nuk kanë politika për menaxhimin e bullizmit dhe dhunës dixhitale

Rrjetet sociale përmenden si shkaktarë të dhunës, por nuk ka politika të dukshme brenda shkollave për të menaxhuar ngacmimet në platformat dixhitale.

Përfundim

Ky monitorim evidentoi sfida dhe mangësi në sistemin e raportimit dhe trajtimit të ngacmimeve në shkollat e mesme të Komunës së Lipjanit. Edhe pse ekziston një kornizë ligjore në nivel qendror, zbatimi lokal është i pjesshëm dhe jo gjithmonë efektiv. Analiza ligjore tregon udhëzime të qarta, por të gjeturat nga terreni zbulojnë prezencë të ngacmimeve (sidomos në shkollat e larta) dhe dyshime për efektivitetin e mekanizmave bazë të raportimit. Mungesa e një rregulloreje specifike komunale dhe perceptimet negative të nxënësve (frika, mungesa e besimit, konfidencialiteti) janë barriera të rëndësishme. Raporti identifikoi mangësi kryesore si mungesa e rregullores komunale, kutitë e ankesave joefektive, mungesa e zyrtarëve për barazi gjinore dhe politika për dhunën dixhitale. Për të siguruar një mjedis të sigurt dhe mbështetës, implementimi dhe efektiviteti i mekanizmave ekzistues kërkon përmirësime.

Rekomandime

Për DKA-në:




- ✓ Hartimi i rregullores komunale për trajtimin e ngacmimeve.
- ✓ Monitorimi aktiv i zbatimit të protokollit dhe ofrimi i trajnimeve.
- ✓ Emërimi i zyrtarëve komunalë për mbrojtjen e fëmijëve dhe barazi gjinore.
- ✓ Mbështetja e shkollave për krijimin e mekanizmave të sigurt raportimi (anonime, online).
- ✓ Zhvillimi i programeve të vetëdijësisë dhe trajnimit për të gjithë akterët.
- ✓ Fuqizimi i bashkëpunimit me institucionet relevante (policia, qendrat për punë sociale, etj.).

Për shkollat:

- ✓ Funksionalizimi dhe trajnimi i Ekipeve për Parandalimin dhe Referimin e Dhunës.
- ✓ Sigurimi i konfidencialitetit dhe ndërtimi i besimit në raportim.
- ✓ Përmirësimi i mekanizmit të kutisë së ankesave (hapja e kutive në përputhje me protokollet ekzistuese).
- ✓ Emërimi i zyrtarëve shkollorë për barazi gjinore.
- ✓ Hartimi i politikave të brendshme për trajtimin e bullizmit dhe dhunës dixhitale.
- ✓ Angazhimi aktiv i psikologëve/pedagogëve shkollorë.

Për Këshillat e Nxënësve:

- ✓ Rritja e vetëdijes dhe inkurajimi i nxënësve për t'i raportuar rastet.
- ✓ Përfaqësimi i shqetësimeve dhe sugjerimeve të nxënësve tek stafi..



Prishtinë, 2025